



RELACION

Mbi aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2025, nga Universiteti Polis
në kuadër të Projektit “Vendbanimet dhe Banesa Fshatare e Shqipërisë Jugore”

Hartuan:

Marsela Plyku Demaj, Dr. Genti Avdija, Dr. Ketil Hoxha

Tiranë, Shkurt 2026

Hyrje

Ky raport hartohet në kuadër të projektit “Vendbanimet dhe Banesa Fshatare e Shqipërisë Jugore” me drejtues shkencor Prof. Dr. Pirro Thomo, financuar nga AKKSHI dhe administruar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Materiali është mbledhur gjatë ekspeditës së parë të kërkuesve shkencorë Marsela Demaj, Dr. Genti Avdija dhe Dr. Keti Hoxha të Universitetit Polis, në kuadrin e gjurmimit dhe dokumentimit të vendbanimeve dhe ndërtimeve fshatare në zonën e Mokrës, Pogradec.

Ekspedita përnjohëse u zhvillua në periudhën 30 Nëntor - 2 Dhjetor 2025 dhe pati në fokus një pjesë të Malësisë së Mokrës, Pogradec, përkatësisht fshatrat Potgozhan, Pleshisht (Njësia Administrative Trebinjë), Selcë e Poshtme, Slabinjë (Njësia administrative Proptisht), si dhe fshatin Velçan.

MOKRA – Vështrim Etnografik, Gjeografik e Kulturor

Zona e Mokrës është një njësi etnografike që bën pjesë në grupin e madh historiko etnografik të jugut të Shqipërisë, të quajtur Toskni / Toskëri, përkatësisht në anën Lindore të Toskërisë.¹ Struktura e saj gjeografike është më tepër malore se fushore.

Malësia e Mokrës shtrihet në jug të fushëgropës së Përrenjasit dhe Qafës së Thanës, midis Malësisë së Gorës (kurrizi Shkëmbi i Llangës – Maja e Kultit-Gështenjas në jug, luginës së Shkumbinit të sipërm në perëndim dhe Gropës së Pogradecit në lindje, pothuajse me gjatësi dhe gjerësi të njëjtë, rreth 20 km². Ajo përshkruhet nga shumë degë të Shkumbinit që rrjedhin në drejtime të ndryshme dhe ndahen nga ujëndarës të çrregullt, me kreshta të rrumbullakosura ose të sheshta dhe shpate të thepisura ose të shkallëzuara. Lartësitë e saj ulen gradualisht nga jugu në veri.

Mokra përbëhet nga 47 fshatra të gjithë të vendosur 1000 m mbi nivelin e detit. Krahina ndahet nga lumi Shkumbin në dy nënkrahina, Mokra e Sipërme dhe Mokra e Poshtme.

Nga pikëpamja gjeologjike, kjo malësi është e përbërë kryesisht nga molasat që përfaqësohen nga ranorë, konglomerate dhe argjila të ndërthurura me njëra tjetrën. Pjesa lindore e malësisë përbëhet nga magmatikët dhe gëlqerorët vendosen mbi ta, ndërsa në perëndim të saj ndodhen gëlqerorët.. Duke qenë se shkalla e çimentimit të ranorëve dhe konglomerateve nuk është e njëjtë, për shkak të erozionit të diferencuar , janë krijuar mikroforma të relievit në traja nga më interesantet (kërpudha, shtylla, mullarë bari, këmbë elefanti etj..) Më të shprehura këto forma janë pranë fshatit Trebinjë ku edhe njihen me toponime e legjenda lokale si “Guri i Nuses” (Foto 1) etj. (Krutaj , etj., 1991)

Bimësia në malësinë e Mokrës në përgjithësi është e varfër dhe përbëhet nga dushqet më tepër në formën e shkurreve , nga ahishtet dhe aty këtu nga halorët.

Toponimet - Mjedisi natyror ka luajtur një rol thelbësor në krijimin, vendosjen, shtrirjen madje edhe në toponiminë e vendbanimeve. Shqipëria paraqet ndoshta një nga rastet e rralla, ku rreth 1/5 e vendbanimeve kanë huazuar emra të elementeve të mjedisit natyror. Janë jo të pakta vendbanimet tona

¹ (sipas Zojsi Rr., 1976, në lindje të Toskërisë bëjnë pjesë Nahija e Pogradecit, Fusha e Korçës, Devollin, Gorën, Oparin, Vakëfet e Dangëllinë)

emrat e të cilave shfaqen si hidronime, oronime, me emra të bimëve, kafshëve, madje ato mbartin cilësi të mjedisit ku janë krijuar.



Foto 1 - “Guri i Nuses”, Mikroforma të relievit pranë fshatit Trebinjë - shkaktuar nga fenomeni i erozionit (M.Demaj 2025)

Rrjeti Rrugor

Gjatë antikitetit, në krahinën e Mokrës, rrjeti rrugor zë një vend të veçantë. Roli i tij si tregues për krijimin e qendrave dhe vendbanimeve me karakter politik, tregtar dhe prodhues nuk mund të vihet në dyshim. Ceka dhe Papajani (1971) theksojnë se nga pikëpamja gjeografike, lugina e Shkumbinit ka qenë që në kohën e lashtë një nga rrugët më të përshtatshme natyrore për komunikimin ndërmjet pjesës bregdetare të Ilirisë së Jugut dhe brendësisë së Ballkanit. Ata mbështesin idenë se komunikimi ekonomik i vendbanimeve të ngritura përgjatë luginës së Shkumbinit, nuk lind me ndërtimin e rrugës romake Egnatia por e paraprin atë. Sa i takon rrugës Egnatia, gjurmët të të qarta të trasesë së rrugës egnatia ndeshen në pjesën malore nga Miraka në Qukës² Në Mokër kalonte një degëzim i rrugës Egnatia.

Popullsia

Për prejardhjen e emrit Mokër ka një të dhënë në testamentin e lënë nga Gjin Muzaka, ku emri i krahinës përmendet si vendi i mullinjve (në gjuhën shqipe, fjala “mokër” do të thotë “gur mulliri”). Dhe vërtet, zona ka përrenj të shumtë e ujë të bollshëm, dhe ka qenë e njohur për mullinjtë e shumtë. Karakteristikë tjetër e kësaj zone është folklori shumë i pasur, veshjet karakteristike, dhe ruajtja e këngëve të vjetra legjendare të përhapura në tërë Shqipërinë (kënga e Ymer Agës, balada e murosjes, etj.). Zona e Mokrës sipër ka një terren të thyer malor, ku mbizotëron mali i Kozicës, prej të cilit rrjedhin përrenj të shumtë, që bashkohen në rrjedhën e lumit Shkumbin. Pikërisht ky terren, bëri që zona të arrijë t’i shpëtojë disi ndikimit të pushtuesve otomanë. Nga qendrat e para të banuara të kësaj njësie ka qenë fshati Llëngë,

² (Ceka & Papajani, 1971)

pranë të cilit kalonte një degëzim i rrugës Egnatia (e cila bënte lidhjen me fshatin Niçë, e më tej më Voskopojën).

Gjatë periudhës së ndritur të Rilindjes Kombëtare, Mokra u bë nga vatrat më të spikatura të përhapjes së shkrimit dhe këndimit shqip në tërë qarkun e Korçës e më gjerë. Në fillim të shekullit të XIX mërgimtarët e fshatit ndërtuan në Podgozhan një shkollë greke e cila daton që në vitin 1811. Në vitin 1891, vetëm 4 vjet pas hapjes së të parës shkollë shqipe në Korçë, në shkollën e Podgozhanit At Jovan Vako u mësonte fshehurazi fëmijëve gjuhën shqipe me gërmat e alfabetit të Sami Frashërit.³

Popullsia e zonës së Mokrës ashtu si dhe e shumë vendbanimeve rurale të zonave periferike të vendit, pas vitit 1990, do të gjenin si shpëtim të vetëm largimin prej tyre dhe përfshirjen në emigracionin e jashtëm apo migrimin e brendshëm. Ato që mbeten pas gjithë këtyre largimeve janë hapësirat e braktisura dhe të harruara (McKay, 2019 cituar në (Doka, 2023).

Sot (bazuar në PPV Pogradec), popullsia që rezulton në gjendjen civile nuk përkon me atë realen për shkak të lëvizjes së vazhdueshme migratore drejt Vërdovës, Starovës, qytetit të Pogradecit, dhe emigrimit (kryesisht drejt Greqisë). Me ndërtimin e rrugës Qukës-Qafë Plloçë, është vënë re një tendencë e banorëve për t'u rikthyer dhe për të riparuar shtëpitë, sidomos në fshatrat pranë të cilëve kalon kjo rrugë (Kalivac, Potkozhan, Malinë, Trebinjë, Pevelan).

³ Zylyftar Hoxha: *“Udhëtime nëpër Shqipëri”, guidë kulturore dhe historike”, faqe 57 – 61*




Foto 2 - rrjeti rrugor përgjatë luginës së Shkumbinit gjatë antikitetit Burimi:
(Ceka & Papajani, 1971)

Vendbanimet fshatare të Shqipërisë

Fillesat e gjurmimit të banesës fshatare lidhen me vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 1974, ndërtimet popullore me vlera arkitektonike-historike dhe etnografike në fshat dhe në qytet duhet të grumbulloheshin në mënyrë të organizuar nga një sërë institucionesh që u ngarkuan për këtë qëllim, dhe kjo punë duhet të përfundoi brenda viteve 1978-80.

Një numër i madh ekspeditash të zhvilluara, mundën të mbledhin material të vlefshëm për studimin e banesës fshatare. Vëllimet “Vendbanimet dhe banesa fshatare në Shqipërinë e Veriut” ribotuar nga Thomo (2021) si dhe “Banesa Fshatare dhe Familja e madhe” botuar nga Muka A. (2001), apo “Banesa Fshatare në Labëri” botuar nga Riza (1984) janë një pjesë e botimeve që prezantuan tipare të vendbanimeve dhe të banesës fshatare në këto zona.

EKSPEDITA PËR NJOHËSË – MOKËR, Dhjetor 2025

FSHATI POTGOZHAN

Fshati Potgozhan bën pjesë në njësinë administrative Trebinjë, e cila është ndoshta njësi më e varfër e Bashkisë Pogradec.

Në bazë të PPV Pogradec, fshati Potgozhan (me rreth 33 familje sot), është një nga qendrat e banuara që në kohë të hershme janë fshati Potkozhan, i cili ndodhet nën malin e Kozicës (mendohet të ketë qenë i banuar që para shek. X), Veç bujqësisë e blegtorisë, banorët e kësaj zone (kryesisht të fshatrave Pleshisht, Pevelan e Potkozhan) kanë qenë mjeshtër gurgdhendës e muratorë të shquar, dhe një pjesë e mirë e tyre kanë punuar edhe në mërgim, kryesisht në Rumani.

Kontaktet që krijuan me Rilindasit shqiptarë në Rumani, bënë që në këto fshatra të çelen të parat shkolla shqipe për zonën e Mokrës. Në fshatin Potkozhan është çelur dhe shkolla e dytë shqipe në vitin 1908, që kish 20 nxënës.

Organizimi i vendbanimit

Vendbanimi i fshatit Potgozhan përbëhet nga dy grupime kryesore ndërtimesh nga të cilat grupimi i parë pranë kishës së Shën Parashqevisë i vendosur në një kodrinë mbi rrugë, dhe grupimi i dytë pranë kishës së shën Mitrit i shtrirë përgjatë rrugës.

Kompleksi i kishës së Shën Parashqevisë me zonën e varrezave dhe çezmën (shih foto 7) buzë rrugës, mund të konsiderohet si qendra morfologjike e vendbanimit.



Foto 3 – Foto ajrore ASIG – e fshatit Potgozhan




Foto 4 – Planimetri e vendbanimit, fshati Potgozhan, 1- Kisha e Shën Parashqvisë, 2- Kisha e Shën Mitrit, 3- Godinat e ish Rezervave të shtetit, pjesë e minierës së qymyrit




Foto 5 – Kisha e Shën Parashqvisë dhe varrezat e vjetra pranë saj (shiko Nr.1 në foton 4)



Foto 6 – Kisha e Shën Mitrit (*shiko Nr.2 në foton 4*)



Foto 7 – Çezma Potkozhan



Foto 8 – Pamje e minierës të qymyrit në Potkozhan si dhe godinat e ish
rexervave të shtetit – *shih numrin 3 në foton 4.*

Rrugët

Rrugicat ruajnë gjurmë të shtrimit me kalldrëm i cili duket se ka qenë ekzistues deri vonë dhe është prishur për shkak të punimeve për ujësjellësin. Rrugicat e grupimit të vendbanimit në kodrinë janë të ngushta dhe gjarpëruese duke ndjekur konturet e terrenit. Ndërtimet në këtë grupim kanë orientim të detyruar dhe në disa raste dalin me një faqe në rrugë e në shumë raste të tjera rrugica kalon përgjatë murit të oborrit.



Foto 9 – Pamje e rrugëve si dhe pamje e banesave me faqe në rrugë

Banesat

Banesat qendrojnë brenda një rrethimi i cili kufizon një truall të caktuar që formon oborrin e banesës, pjesë përbërëse e saj edhe në kuptimin e pronësisë. Në disa raste oborret janë relativisht të vogla ndoshta si pasojë e ndarjes së familjes në disa kurorë. Oborret e banesave ruajnë pjesërisht shtrimet me rasë guri, gurë ose kalldrëm.



Foto 10 - Pamje e rrethimeve të banesës



Foto 11 - pamje e shtrimit të oborrit

Ndërtimet ndihmëse

Banesa fshatare është një kategori që nuk mund të njehsohet vetëm me të ndërtimin kryesor. Oborri luan një rol me rëndësi në jetën e përditshme sepse në të janë ndërtuar ndërtime ndihmëse me funksione të rëndësishme jetësore. Ndërsa banesa ndërtohej nga mjeshtrit e ndërtimit, ndërtimet ndihmëse ndërtoheshin nga vetë fshatarët. (Riza, 1984)

Brenda oborrit përfshihen kasollet për mbajtjen e bagëtive dhe rezervave ushqimore, furra dhe vendi i zjarrit (ashefi – kuzhina jashtë banesës). Kasollet pranë banesës shërbenin për strehimin e bagëtive dhe ruajtjen e barit ose shërbenin vetëm për funksionin e dytë.

Kasollet janë me plan drejtkëndor. Muret janë ose të ndërtuara me thupra e llaç balte ose me muraturë guri e kombinuar me tulla qepiçi. Muratura me gurë / qerpiç përdoret kur kasollja i përfshin funksionin e strehimit të kafshëve.

Furrat janë të vogla, me planimetri katrore dhe të ndërtuara me tullë e të mbuluara ose me tjegull ose me llamarinë të valëzuar.



Foto 11 – Tipe Kasollesh - Potgozhan



Foto 12 – Furra dhe pusët në oborr të banesës

Banesat u vizituan kryesisht nga jashtë për shkak se ishin mbyllur si dhe për shkak të rezervimit të banorëve.

Banesat në Potgozhan ishin përgjithësisht një dhe dy katëshe. Banesat janë të ndërtuara me muraturë guri me rreshta të rregullt dhe me qoshe të punuara me gurë të skalitur. Si tip banese mbizotëron banesa me theksim qendror që mund të jetë ose në formën e qoshkut të dalë mbi hyrjen kryesore të banesës, ose në formën e çardakut të mbyllur në banesë me zhvillim planimetrik me dy krahë.



Foto 13 – shembuj të banesave me theksim qendror (tip me qoshk)

Në pjesën më të lartë të grupimit të parë të banesave u evidentua një banesë interesante me hajat (Foto 14).




Foto 14 – Banesë me hajat

FSHATI PLESHISHT

Fshati Pleshisht bën pjesë në njësinë administrative Trebinjë, e në bazë të PPV Pogradec aty aktualisht banojnë 61 familje. Vendbanimi përbëhet nga disa grupime dhe krahasimisht me vendbanimin në Potgozhan, banesat ndodhen me më shumë distancë nga njëra tjetra. Grupimet e banesave organizohen përgjatë rrugës. Në skajin perëndimor të fshatit ndodhet Kisha e Shën Kollit ndërsa në pikën më të lartë të kodrës mbi fshat qendron kisha e profetit Ilia.



Foto ajrore - Pleshisht





Kisha e Shën Kollit, Fshati Pleshisht



Kisha e Profetit Ilia, Pleshisht



Çezma, Pleshisht

Rrugët

Edhe në Pleshisht evidentohen dy raste të marrëdhënies së banesës me rrugën, ose dalja e një faqeje të banesës në rrugë ose marrëdhënia me murin e oborrit. Rrugët ishin totalisht të pashtuara dhe kalldrëmet ishin të zhdukura si pasojë e ndërhyrjeve të ujesjellësit para 2 vitesh.



Foto – Marrëdhënia me rrugën

Ndërtime Ndhmëse në oborrin e banesës

Kasollet



Furrat



Oborri

Në Pleshisht u evidentua fenomeni i disa banesave me oborr të përbashkët. Kryesisht ky fenomen ndodh në banesa të së njëjtit trung familjar ose me lidhje farefisnie.



Tipe të Banesave

Edhe në Pleshisht – mbizotëron tipi i banesës me theksim qendror. Në disa raste (ndoshta në banesa të ndërtuara pas luftës II Botërore) theksimi ishte vetëm në formën e theksimit të hyrjes në katin përdhe dhe në shumë banesa ishte në formën e daljes në formë qoshku.

Banesat ndërtohen me muraturë guri me breza druri, me qoshe të punuara me gurë të skalitur e të dekoruar.





Elemente etnografikë në interior banese dhe mjeshtëri

Në Pleshisht, përveç shënimit të elementeve etnografikë të lidhura me jetën e përditshme si qilimbërja, përpunimi i qumështit (fti), u evidentua edhe prania e mjeshtërisë së bërjes së samareve për kafshët.



FSHATI SLABINJË

Fshati Slabinjë është pjesë e njësisë administrative Proptisht. Popullsia në fshatin Slabinjë ishte e besimit mysliman.

Bazuar në PPV e Pogradecit në njësinë Proptisht - Bujqësia zhvillohet në masën 70% dhe Blegtoria (30%). Kulturat kryesore që kultivohen janë gruri, misri, tërshëra, fasulet, patate, foragjeret e perimet e ndryshme. Infrastruktura bujqësore është tejet e amortizuar dhe e dëmtuar.



Foto – Pamje e vendbanimit në fshatin Slabinjë

Banesat tradicionale evidentohen më rrallë në këtë fshat, niveli i ndërhyrjes dhe i ndërtimit është më i madh. Në fshat evidentohet një ndërtesë shkollë si dhe disa ndërtesa multifamiljare gjë që tregon për një popullsi më të madhe.



Foto – shkolla Slabinjë

Rrugët

Rrugët përgjithësisht ishin me asfalt por kishte edhe rrugica ku evidentoheshin gjurmë të shtrimit me kalldrëm



Tipe të banesave

Sërish mbizotëron tipi i banesës me theksim qendror në këtë rast hapësira qendrore në katin e sipërm është e futur në formë të një çardaku të hapur ose llozhe. Megjithatë u evidentua një banesë e variantit me një krah.








Oborri

Një element i veçantë ishte mos evidentimi në mënyrë të qartë i ndarjes së oborrit nga rruga. Pra rrethimi i oborrit nuk ishte gjithmonë i pranishëm





Ndërtimë Ndihmëse

Kasollet



Foto - Kasolle

Elementë të veçantë të banesës

Në disa banesa u evidentuan ulluqe prej guri që dalin në fasadë (në nivelin e dyshemesë së katit të sipërm). Integrimi i këtyre elementeve ishte veçanti e disa banesave për shkarkimin e ujit të përdorur në ambjentet e brendshme.



Ulluqe guri në fasadë (muslluk)



Suvatim i llozhës në fasadën ballore me llaç balte me lidhës kashtë



Elementë etnografikë të evidentuar në interior – Sofra, Kade, Fti etj.

FSHATI VELÇAN

Fshati Velçan është pjesë e njësisë administrative Velçan. Velçani është një nga fshatrat e mëdhenj të Mokrës së Poshtme, dhe ndahet në disa lagje. Paria e këtij fshati, historikisht ka dominuar të gjithë zonën e Mokrës. Edhe në këtë zonë ka gjurmë që dëshmojnë për vjetërsinë e zonës, psh. toponimet nga koha e pushtimit romak (me origjinë latine), Bishnicë nga “bosco” (pyll), Laktesh nga latinishtja “lactum”, që ka kuptimin “qumësht”, Shpellë nga “speleo” (shpellë), etj.

Fshatrat më të rinj të zonës përmenden fshatrat Zgallë e Jollë (të cilët janë sot dhe fshatrat më periferikë), dhe janë banuar nga të ardhur nga fshatrat e rrethit fqinjë të Gramshit. Kanë qënë fshatarë të varfër, që kanë ardhur të punojnë si bujq në tokat e pronarëve të mëdhenj vendas.

Bazuar në PPV Pogradec, Bujqësia zhvillohet në masën 60% dhe Blegtoria 40%. Kulturat kryesore që kultivohen janë gruri, patatet, foragjeret e perimet e ndryshme. Kanali i dytë i rezervuarit në Buzahishtë është sistemuar me kontributin e vetë banorëve. Kafshët që mbarështohen janë gjedhët, lopët, delet, dhitë, njëthundrakët, shpendët, derrat e bletët. Në të gjithë zonën ka vetëm një baxho në Buzahishtë. Ka edhe ferma në nivel familjar, me rreth 150 krerë bagëti të imët dhe 10 krerë lopë.

Popullsia në fshatin Velçan është e besimit mysliman. Lagjet e fshatit ndahen në grupime banesash sipas mbiemrave të familjeve. Vendbanimi është i shpërndarë në disa grupime të vendosura në disa shpate kodrash. Brenda secilit grupim banesad janë të vendosura afër njera tjetrës. Banesa më e vjetër sipas shoqëruesit të grupit – kryetarit të njësisë administrative është në vitet '50.

Lagjet janë: Elezi, Bregu i Fushës, Lagja e diellit, Lagja e Çelës, Lagja e Bibës, Lagja e Torrës, Lagja e Rrapçeve.





Çezma, Velçan

Oborri

Jo gjithmonë u evidentua ndarje e qartë oborri. Kjo mendohet se vjen nga fakti që grupimet përfshijnë banesa të të njëjtit fis dhe ndërtimet ndihmëse në oborr mund të përdoren në mënyrë të përbashkët (hipotezë)





Gur varri i periudhës osmane i evidentuar në varrezat e fshatit



Elementë guri të qosheve në banesë – gur me mbishkrim me emrin e ustait të qosheve Bajram Pishkashi

Tipe banesash

Është interesant që tipi i banesës me theksim qendror evidentohet edhe në Velçan në banesat më të vjetra. Në këtë rast volumi qendror i dalë është në të dy katet dhe përkon me hyrjen në banesë.



Tipe banesash me theksim qendror




Banesë e re – që ruan tipin “me theksim qendror”

PËRFUNDIM

Grupi i kërkuesve shkencorë në vijim të zhvillimit të ekspeditës së parë përnjohëse, gjykon që fshatrat e vizituara të dokumentohen në shkallë vendbanimi, por në mënyrë më të detajuar të dokumentohen nga dy njësi banesash përkatësisht në fshatin Potgozhan dhe Pleshisht.

Banesa të propozuara për dokumentim në Potgozhan



Banesa të propozuara për dokumentim në Pleshisht



Për qëllim krahasimi grupi mendon të evidentojë tipin e banesave në Slabinjë por në këto fshatra nuk mendohet të zgjidhen banesa për dokumentim të detajuar.

Banesa të propozuara për dokumentim në Slabinjë

